



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Akte të papublikuara

1997

Ekstra 18

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 99, datë 24.2.1997	Për përcaktimin e disa kriterëve lokale për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve që janë në vështirësi ekonomike.....	5
Vendim i KM nr.100, datë 27.2.1997	Për shitjen e tokës me sipërfaqe 5 hektarë në Parkun e Madh të Tiranës në favor të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.....	5
Vendim i KM nr.101, datë 11.2.1997	Për shitjen e karburanteve.....	6
Vendim i KM nr.110, datë 4.3.1997	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.24, datë 20.1.1997 “Për përdorim fondesh buxhetore për blerje banesash për ish-të përndjekurit politikë”.....	6
Vendim i KM nr.111, datë 4.3.1997	Për transferim të fondeve buxhetore për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtarake me kushte të vështira për vazhdimin e veprimtarisë prodhuese.....	7
Vendim i KM nr.113, datë 20.1.1997	Për normat e strehimit në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore	7

Vendim i KM nr. 114, datë 24.2.1997	Për lejimin e eksportit të 720 m ³ elemente druri, gjysmë të përpunuara, gjendje, të prodhuara nga shoqëria “Libadeko” sh.p.k. Librazhd.....	8
Vendim i KM nr.116, datë 24.2.1997	Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, livrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës të Shqipërisë	8
Vendim i KM nr.119, datë 6.3.1997	Për miratim prokurimi të drejtpërdrejtë.....	11
Vendim i KM nr. 130, datë 16.3.1997	Për furnizimin me karburante.....	11
Vendim i KM nr. 131, datë 18.3.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.80, datë 17.2.1997 “Për një shtesë fondesh në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit”.....	12
Vendim i KM nr. 134, datë 20.3.1997	Për përfshirjen e objekteve të postës dhe të telekomunikacioneve në listën e objekteve të rëndësisë së veçantë.....	12
Vendim i KM nr. 135, datë 20.3.1997	Për vlerësimin e dëmeve të objekteve shtetërore.....	13
Vendim i KM nr. 138, datë 20.3.1997	Për administrimin e dhurimeve financiare nga persona fizikë e juridikë me banim e seli brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	13
Vendim i KM nr. 139, datë 15.3.1997	Për shpërblimin e punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.....	14
Vendim i KM nr. 142, datë 21.3.1997	Për ruajtjen fizike të disa personaliteteve të larta shtetërore.....	14
Vendim i KM nr. 143, datë 21.3.1997	Për një transferim të fondeve buxhetore Shërbimit Informativ Kombëtar nga fondet e akorduara për gjendjen e jashtëzakonshme Ministrisë së Brendshme.....	15
Vendim i KM nr. 145, datë 26.3.1997	Për miratimin e memorandumeve financiare të programeve të Bashkimit European PHARE/CROSS BORDER 1996 përkatësisht me Italinë dhe Greqinë.....	15
Vendim i KM	Për një shtesë fondesh buxhetore për pastrimin e qytetit të	

nr. 146, datë 26.3.1997	Tiranës.....	16
Vendim i KM nr. 147, datë 26.3.1997	Për kryerjen e investimeve me fonde shtetërore nga drejtoritë e ujërave të rretheve për tremujorin e parë 1997 për rehabilitimin e disa objekteve të ujitjes dhe kullimit.....	16
Vendim i KM nr. 148, datë 26.3.1997	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.160, datë 9.7.1975 “Për normat e ushqimit të ushtrisë dhe të organeve e reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.....	17
Vendim i KM nr. 149, datë 26.3.1997	Për miratimin në parim të marrëveshjes kuadër ndërmjet SOSKINDERDORF INTERNATIONAL dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.....	17
Vendim i KM nr. 150, datë 21.3.1997	Për kalimin në likuidim të ndërmarrjes së flotës detare tregtare në Durrës.....	18
Vendim i KM nr. 153, datë 26.3.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995 “Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë”.....	18
Vendim i KM nr. 154, datë 30.3.1997	Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së pasaportave të zakonshme tip i vjetër si dokument identiteti dhe pajisjen me pasaporta të reja	19
Vendim i KM nr. 159, datë 6.4.1997	Për miratimin në parim të projekt marrëveshjes për statusin e forcave shumëkombëshe, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara (vendeve dërguese).....	19
Vendim i KM nr. 165, datë 11.4.1997	Për krijimin e komisionit të posaçëm qeveritar për koordinimin e veprimtarisë shtetërore në marrëdhëniet me përfaqësuesit e misioneve/forcave shumëkombëshe të pranishme në Shqipëri.....	20
Vendim i KM nr. 167, datë 11.4.1997	Për miratimin e marrëveshjes së grantit italian ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), si administratore e fondeve grant të dhëna nga Republika e Italisë për projektin e pyjeve.....	21
Vendim i KM nr. 169, datë 11.4.1997	Për prokurimin me procedurë të përshpejtuar për disa artikuj që lidhen me plotësimin e nevojave urgjente për funksionimin e burgjeve dhe institucioneve të riedukimit.....	21
Vendim i KM nr. 170, datë 8.4.1997	Për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.....	22

Vendim i KM Nr. 171, datë 19.4.1997	Për funksionet e sekretarëve të shtetit në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar.....	23
Vendim i KM nr. 172, datë 19.4.1997	Për shpalljen e Shqipërisë vend i lirë nga afta epizootike.....	23
Vendim i KM nr. 178, datë 19.4.1997	Për shpenzimet e kthimit në atdhe të trupit të mjekut Zamir Shazi.	24
Vendim i KM nr. 179, datë 19.4.1997	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 16.4.1996 “Për disa ndryshime në pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.....	24
Vendim i KM nr. 180, datë 11.4.1997	Për prokurim me procedurë të përshpejtuar për disa artikuj që lidhen me plotësimin e nevojave të gatishmërisë.....	25
Vendim i KM nr. 181, datë 19.4.1997	Për prokurimin me procedurë të përshpejtuar për rikonstruksionin e meremetimin e objekteve të komisarivateve dhe reparteve të Ministrisë së Brendshme.....	25
Vendim i KM nr. 182, datë 19.4.1997	Për prokurim të drejtpërdrejtë.....	26
Vendim i KM nr. 183, datë 19.4.1997	Për prokurim të drejtpërdrejtë.....	26
Vendim i KM nr. 184, datë 19.4.1997	Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 6.4.1997 “Për miratimin në parim të projekt marrëveshjes për statusin e forcave shumëkombëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara (vendeve dërguese)”.....	27
Vendim i KM nr. 186, datë 25.4.1997	Për miratimin e shtesës së financimit për përfundimin e perdes së kundërfiltrimit në impiantin hidroteknik të Bovillës.....	27
Vendim i KM nr. 187, datë 25.4.1997	Për zbatimin e përkohshëm, që nga momenti i nënshkrimit, të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikë të Shqipërisë dhe qeverive të shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe për statusin e kësaj force”.....	28
Vendim i KM nr. 196, datë 2.5.1997	Për miratimin në parim të projektit “Zooteknia e integruar në Shqipëri” dhe financimin e tij me grant të Qeverisë italiane.....	28
Vendim i KM nr. 197, datë	Për autorizimin e hyrjes mbi bazë të përkohshme për arsye humanitare në ujërat tona territoriale të anijeve të specializuara	

2.5.1997	italiane.....	29
Vendim i KM nr. 198, datë 2.5.1997	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993 “Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit”, ndryshuar me vendimin nr.763, datë 11.11.1996.....	29
Vendim i KM nr. 199, datë 2.5.1997	Për zbatimin e ligjit nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”.....	31
Vendim i KM nr.200, datë 2.5.1997	Për disa masa për forcimin e ruajtjes së mallrave, pajisjeve e objekteve ushtarake dhe shtetërore.....	32

VENDIM
Nr. 99, datë 24.2.1997

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA KRITEREVE LOKALE PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË
EKONOMIKE TË FAMILJEVE QË JANË NË VËSHTIRËSI EKONOMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshillat e bashkive dhe të komunave kanë të drejtën të përcaktojnë disa kriteret lokale për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve, në bazë të gjendjes socialekonomike të tyre.

Në këto kriteret do të merren parasysh niveli i të ardhurave të familjeve, gjendja sociale e shkaktuar nga humbja në firmat rentiere, humbja e shtëpive, si dhe kushtet shëndetësore të personave të familjes.

2. Ky vendim do të zbatohet vetëm për fondin shtesë të akorduar për mënjanimin e pasojave socialekonomike të krijuara.

3. Fondi shtesë i ndihmës ekonomike, i akorduar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 17.2.1997, do të çelet për një periudhë njëmuajore, në momentin që njësitë do të paraqesin kërkesat e tyre pranë Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, e cila bën vlerësimin sipas kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen këshillat e bashkive dhe të komunave.

5. Ngarkohet Administrata e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale për përgatitjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr. 100, datë 27.2.1997

**PËR SHITJEN E TOKËS ME SIPËRFAQE 5 HEKTARË NË PARKUN E MADH TË
TIRANËS NË FAVOR TË AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
NË TIRANË**

Në mbështetje të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozim të Bashkisë së Tiranës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë shitjen e tokës me sipërfaqe 5 hektarë në Parkun e Madh të Tiranës në favor të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

2. Vlera totale e shitjes paraprakisht do të jetë 60 milionë lekë. Vlera përfundimtare do të përcaktohet mbasi të jenë konsultuar preventivat e shpenzimeve për punimet e infrastrukturës së jashtme.

3. Pagesa do të bëhet mbasi të dorëzohen dokumentet e plota për punimet e kryera nga firma “Globex” brenda dhe jashtë sheshit të ndërtimit.

4. Ngarkohet Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm dhe të realizojë shitjen e tokës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.101, datë 11.2.1997

PËR SHITJEN E KARBURANTEVE

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënia e së drejtës për shitjen e karburanteve, të vajgurit e të gazit të lëngët, me pakicë ose me shumicë, në pika stacionare ose në mënyrë ambulatorë, si dhe dhënia e shesheve dhe lejeve të ndërtimit, bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.267, datë 21.6.1994, nr.573, datë 29.11.1994 (ndryshuar me vendimin nr.1, datë 9.1.1995), si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.110, datë 4.3.1997

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.24, DATË 20.1.1997 “PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE
BANESASH PËR ISH-TË PËRNDJEKURIT POLITIKË”

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.24, datë 20.1.1997 “Për përdorim fondesh buxhetore për blerje banesash për ish-të përndjekurit politikë”, shtohet paragrafi:

1. Brenda shumës totale prej 49.9 milionë lekësh, fondi prej 38 milionë lekë të përdoret për strehimin e ish-të përndjekurve politikë të rrethit të Tiranës.

2. Përdorimi i shumës prej 38 milionë lekësh do të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vetë qytetarëve, sipas listave nominale të shoqëruara me strukturat e apartamenteve tip përkatës të paraqitura nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

3. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave dhe strukturave të apartamenteve tip që i shoqërojnë këto lista për secilin qytetar në bazë të normave të strehimit vë në dispozicion të çdo qytetari shumat limit përkatëse si më poshtë:

a) Për apartamentet (1+1) shumën 0.98 milionë lekë;

b) Për apartamentet (2+1) shumën 12.53 milionë lekë.

4. Enti Kombëtar i Banesave kryen veprimet financiare me shitësit e apartamenteve vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumenteve ligjore që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga personat përfitues.

5. Në rast se brenda afatit prej dy muajve të vënies në dispozicion të fondeve të përcaktuara si më sipër në pikën 3, qytetarët nuk kanë kryer veprimin e blerjes së banesave, atyre u humbet e drejta e trajtimit si familje të pastreha.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe e

Çështjeve Sociale dhe Enti Kombëtar i Banesave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.111, datë 4.3.1997

**PËR TRANSFERIM TË FONDEVE BUXHETORE PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË
DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE USHTARAKE ME KUSHTE TË VËSHTIRA PËR
VAZHDIMIN E VEPRIMTARISË PRODHUESE**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 11.2.1997 dhe me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet buxhetore të planifikuara për tremujorin e parë të vitit 1997 për Ministrinë e Mbrojtjes pakësohet shuma prej 50 milionë lekësh nga zëri “Shpenzime operative”, e cila u shtohet fondeve buxhetore të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale në zërin “Përkrahja sociale e papunësisë”.

2. Fondi prej 50 milionë lekësh do të përdoret në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 11.2.1997 “Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtarake me kushte të vështira për vazhdimin e veprimtarisë prodhuese”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.113, datë 20.1.1997

PËR NORMAT E STREHIMIT NË BANESAT E NDËRTUARA ME FONDE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Normë strehimi në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore sipas këtij vendimi, do të kuptohet sipërfaqja e banimit në metër katror që i takon një personi.

Sipërfaqja e banimit brenda një apartamenti tip i referohet sipërfaqes totale të dhomave të gjumit dhe dhomës së ditës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.567, datë 6.12.1993 “Për normat e projektimit të banesave”.

2. Norma e strehimit për familjet që trajtohen me banesa të ndërtuara me fonde shtetërore është 9—11 m²/person (metër katror për person).

Çdo sipërfaqe e tepërt mbi këtë normë, si dhe çdo sipërfaqe e tepërt ndërtimi mbi normat e projektimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.567, datë 6.12.1993, përballohet me pagesë të menjëhershme nga vetë qytetarët.

4. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.7.1989 “Për administrimin e kërkesave për

banesa dhe shpërndarjen e tyre”, si dhe çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr. 114, datë 24.2.1997

PËR LEJIMIN E EKSPORTIT TË 720 M³ ELEMENTE DRURI, GJYSMË TË PËRPUNUARA, GJENDJE, TË PRODHUARA NGA SHOQËRIA “LIBADEKO” SHPK LIBRAZHD

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të lejohet eksporti i 720 m³ elemente druri, gjysmë të përpunuara, gjendje, të prodhuara para hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 12.2.1996, nga shoqëria “LIBADEKO”, Librazhd.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe bashkia e Librazhdit për verifikimin e kësaj gjendjeje dhe, mbi bazën e procesverbalit të hartuar nga përfaqësuesit e tyre, të kryhet eksporti i kësaj sasive.

3. Eksportimi i kësaj sasive të elementeve të drurit të kryhet brenda datës 30 prill 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.116, datë 24.2.1997

PËR KOMPETENCAT, PROCEDURAT, NËNSHKRIMIN, LIVRIMIN, REGJISTRIMIN, ZBATIMIN, SHLYERJEN DHE RAPORTIMIN E HUAVE, KREDIVE DHE NDIHMAVE TË HUAJA QË I JEPEN QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha huatë, kreditë dhe ndihmat që i jepen Qeverisë së Republikës të Shqipërisë nga shtetet e huaja, organizatat ndërkombëtare, që më poshtë do të quhen financime të huaja, janë pjesë përbërëse të Buxhetit të Shtetit.

2. Ministria e Financave, Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DZHEKNH) dhe Banka e Shqipërisë analizojnë situatën ekonomike e financiare të vendit dhe, mbi bazën e treguesve makroekonomikë, përcaktojnë kuadrin e zhvillimit ekonomik e të investimeve, nevojën dhe mundësitë për marrjen, përdorimin dhe shlyerjen e financimeve të huaja, si dhe vëllimin dhe kushtet e kredive të reja që do të merren në situatat konkrete.

3. Të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore paraqesin pranë DZHEKNH propozime për projekte për t’u përfshirë në programin e investimeve publike, si dhe për projekte të tjera që do të financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime financiare të huaja.

4. DZHEKNH, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, shqyrtojnë kërkesat dhe propozimet e paraqitura nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, ndjekin të gjitha problemet që kanë të bëjnë me përgatitjet paraprake të projekteve dhe programeve që do të jenë objekt i financimeve të huaja, dhe në përfundim paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave programin e investimeve publike për një periudhë 3-5 vjeçare.

5. Miratimi nga Këshilli i Ministrave i Programit të Investimeve Publike nënkupton miratim në parim të projekteve të përfshira në të dhe autorizimin e Ministrisë së Financave ose DZHEKNH për kërkimin e financimit pranë institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit dhe qeverive të vendeve të tjera.

Për projekte të tjera, të papërfshira në programin e investimeve publike e që do të financohen nga burime të huaja, DZHEKNH së bashku me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, i paraqesin këto për miratim në parim në Këshillin e Ministrave, i cili autorizon DZHEKNH ose Ministrinë e Financave për kërkimin e financimit pranë institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit dhe qeverive të vendeve të tjera.

6. Në kuadrin e rritjes së bashkëpunimit të Shqipërisë me shtete të tjera ose organizma ndërkombëtarë, Ministrisë së Punëve të Jashtme i kërkohet mendim në parim për financimin e projekteve nga shtete ose institucione financiare ndërkombëtare

7. Pas marrjes së konfirmimit nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve të tjera për mundësinë e plotësimit të kërkesave për financime, bazuar në përgatitjen para prake të studimeve, të projekteve teknike, planeve dhe masave të tjera të nevojshme që për zbatimin e këtyre projekteve a programeve, Kryetari i Këshillit të Ministrave autorizon zhvillimin e negociatave me donatorë të huaj për përfundimin e marrëveshjes përkatëse të financimit.

8. Palët pjesëmarrëse në negociata dhe raportet ndërmjet tyre janë si vijon:

a) Për marrëveshjet e financimit të projekteve me kredi ose me grant, por që ky i fundit është bashkëfinancim me financim buxhetor ose kreditë e huaja, si dhe për marrëveshjet e garancisë që kërkohen nga qeveria në rastin e kredive të drejtpërdrejta për persona juridikë shtetërorë, Ministria e Financave dhe DZHEKNH janë palë kryesore në negociata.

b) Për marrëveshjet e financimit të projekteve me grante që nuk përbëjnë bashkëfinancim me financimin buxhetor ose kreditë e huaja, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe DZHEKNH janë palë kryesore në negociata.

9. Pas negocimit, Ministria e Financave ose ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në bashkëpunim me DZHEKNH, paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave tekstet e marrëveshjeve të financimit a të garancive dhe, në funksion të natyrës së financimit, Këshilli i Ministrave autorizon Ministrinë e Financave, një anëtar tjetër të qeverisë ose drejtorin e DZHEKNH për nënshkrimin e atyre marrëveshjeve. Në vendimin e Këshillit të Ministrave gjithashtu caktohet institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit.

10. Ministria e Financave, në bashkëpunim me DZHEKNH, përgatisin dokumentacionin dhe aktet e tjera të nevojshme për ratifikimin e marrëveshjeve të kredisë ose garancisë, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë është palë në to dhe kur një gjë e tillë kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi.

11. Sipas rastit, Ministri i Drejtësisë ose këshilltari ligjor i kredimarrësit, lëshojnë opinionin ligjor për marrëveshjen e kredisë a garancisë. Për marrëveshjet e kredisë ose garancisë që lidhen në emër të shtetit shqiptar, pas ratifikimit të tyre nga Kuvendi Popullor, Ministri i Drejtësisë, me kërkesën e Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton se të gjitha dispozitat

ligjore në fuqi janë zbatuar, të gjitha veprimet e nevojshme në kuadrin e marrëveshjes janë ndërmarrë dhe marrëveshjet janë të ligjshme dhe mund të hyjnë në zbatim me forcë të plotë ligjore.

12. Të gjitha transaksionet që lidhen me huatë dhe ndihmat do të ndiqen, regjistrohen dhe raportohen nga Ministria e Financave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që janë në rolin e agjencive zbatuese, që nga momenti i nënshkrimit të tyre, livrimit, përdorimit dhe shlyerjes së tyre. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, nëpërmjet njësive të tyre të zbatimit të projektit, janë të detyruara që t'i raportojnë Ministrisë së Financave dhe DZHEKNH të gjitha të dhënat e kërkuara në këtë drejtim brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave dhe i ndihmave të jashtme do të jetë pjesë përbërëse e buxhetit faktik të çdo viti.

13. Të gjitha të ardhurat nga huatë dhe ndihmat do të regjistrohen si të hyra në Buxhetin e Shtetit nëpërmjet llogarive speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë.

Huatë dhe ndihmat që livrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e kreditorit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave.

14. Shpenzimi i huave dhe i ndihmave të livruara do të regjistrohet në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Për huatë që livrohen nëpërmjet llogarive speciale në Bankën e Shqipërisë, transferimet e bëra nga këto llogari në llogaritë e thesarit ose të përfituesve (njësive të projekteve) të kredisë në bankat e nivelit të dytë, do të regjistrohen si xhirime të brendshme, kurse shpenzimi i tyre do të raportohet përkatësisht nga degët e thesarit në rrethe dhe njësitë e zbatimit të projekteve. Kur huatë dhe ndihmat livrohen në natyrë, në të njëjtën kohë që do të regjistrohen edhe si të ardhura (të hyra) në buxhet, do të regjistrohen edhe si shpenzime (të dala), në bazë të njoftimit të pagesave të kryera për blerjen e mallrave ose shërbimeve përkatëse.

15. Ndihmat në para dhe në natyrë që organet e ndryshme të pushtetit dhe institucionet buxhetore në vartësi të tyre marrin nga shtete, shoqata, firma dhe individë të ndryshëm detyrimisht do të regjistrohen e kanalizohen nëpërmjet llogarive të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, kur jepen në para në dorë dhe drejtpërdrejt në Ministrinë e Financave ose në degët e thesarit në rrethe, kur jepen në natyrë.

Në rast se ministrinë, institucionet qendrore, organet e pushtetit lokal dhe institucionet në vartësi të tyre marrin dhe shpenzojnë ndihma dhe hua pa i regjistruar në llogaritë përkatëse të Buxhetit të Shtetit dhe në sistemin e thesarit, Ministria e Financave bën pakësim të menjëhershëm të fondeve buxhetore të akorduara për vlefshëri e ndihmës dhe huasë së shpenzuar.

16. Ministrinë, institucionet qendrore, Banka e Shqipërisë, bankat tregtare dhe DZHEKNH, brenda muajit mars 1997, të paraqesin në Ministrinë e Financave të gjitha marrëveshjet e kredive dhe të ndihmave të nënshkruara prej tyre ose institucioneve të tjera dhe të livruara nga kreditorët/donatorët drejtpërdrejt në favor të tyre, si dhe të dhënat mbi livrimin e shpenzimin e tyre, deri në datën e raportimit. Ministria e Financave bën azhurnimin, regjistrimin dhe raportimin e tyre, në bazë të sistemit të llogarive dhe strukturës së buxhetit.

17. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, çdo gjashtë muaj (jo më vonë se datat 15 gusht dhe 15 shkurt të çdo viti) përgatisin raportin për gjendjen e çdo projekti a programi, për ecurinë teknike dhe financiare për degën që mbulojnë, dhe ia paraqesin Ministrisë së Financave dhe DZHEKNH, me synim zbatimin në kohë e me efektivitet të tyre.

18. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme lidhur me procedurat gjatë fazave të ndryshme të livrimit, shpenzimit dhe shlyerjes së huave dhe ndihmave si për vetë drejtoritë e saj, ashtu edhe për ministrinë dhe institucionet e tyre qendrore që zbatojnë projektet në kaudrin e marrëveshjeve me donatorët e huaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.119, datë 6.3.1997

PËR MIRATIM PROKURIMI TË DREJTPËRDREJTË

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Të miratojnë blerjen e baterive për teknikën luftarake nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, sipas procedurave të blerjes me prokurim të drejtpërdrejtë për një fond deri në 10 milionë lekë.

2. Fondet sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga zëri i buxhetit kontingjencë i planifikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

VENDIM
Nr. 130, datë 16.3.1997

PËR FURNIZIMIN ME KARBURANTE

Me qëllim që të normalizohet furnizimi me karburante, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kombinati i përpunimit të thellë të naftës në Ballsh dhe uzina e përpunimit të naftës në Fier të vihen menjëherë nën kontrollin e organeve të policisë dhe të mbahen në ruajtje si objekte të rëndësishme shtetërore.

2. Të vihen gjithashtu në ruajtje si objekte të rëndësishme shtetërore të gjitha depot e karburanteve nëpër rrethe dhe pikat e shitjes me pakicë të karburanteve të Albpetrolit.

3. Prodhimi i karburanteve, vajgurit dhe solarit në Ballsh dhe shpërndarja e tyre të bëhet sipas një programi që do të hartojë Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike për të plotësuar nevojat e rendit, të ushtrisë, të administratës shtetërore qendrore e lokale etj.

4. Shpërndarja e karburanteve nga Ballshi të bëhet me hekurudhë, duke e shoqëruar me forca të armatosura, si dhe me automjetet e rezervës së shtetit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 131, datë 18.3.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.80, DATË 17.2.1997 “PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT”

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.80, datë 17.2.1997, pika 2 ndryshohet si vijon:
“Ky fond përballohet nga kontingjenca e Këshillit të Ministrave e tremujorit të parë të vitit 1997”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 134, datë 20.3.1997

PËR PËRFSHIRJEN E OBJEKTEVE TË POSTËS DHE TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË LISTËN E OBJEKTEVE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË

Me propozimin e Departamentit Shtetëror të Postave dhe Telekomunikacioneve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve të rëndësisë së veçantë shtohen:
 - Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve, DSHPT;
 - Drejtoria Transite e Telekomunikacioneve Kombëtare dhe Ndërkombëtare, DTTKN, bashkë me kullat antenëmbajtëse në DTTKN dhe në malin e Dajtit;
 - Filiali i Telekomit të Tiranës;
 - Filiali i Postave Transite, i ndërmarrjes së Postës Shqiptare;
 - Objekti i celularit shqiptar, AMC.
2. Për periudhën kohore të situatës së jashtëzakonshme në të gjitha këto objekte të vendosen mjete të blinduara luftarake.
3. Ministria e Punëve të Brendshme të marrë masat e do të varet kryesisht nga shpejtësia dhe saktësia e paraqitjes së listës së objekteve, shoqëruar me vlerat përkatëse sipas preventivave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 135, datë 20.3.1997

PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË OBJEKTEVE SHTETËRORE

Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të bërë një vlerësim sa më real dhe të shpejtë të dëmeve të shkaktuara nga trazirat e kohëve të fundit, ngarkohen të gjitha ministrat dhe institucionet qendrore të marrin masa urgjente për vlerësimin real të dëmeve të shkaktuara si në objekte shtetërore, ashtu edhe në pajisje e aparatura.
Për vlerësimin e dëmeve të mobilizohen specialistët në vartësi të ministrave dhe, kur është e pamundur, edhe specialistë të licencuar me pagesë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.9.1994.
2. Vlerësimi i shpenzimeve të bëhet për çdo objekt me preventiv, sipas çmimeve në fuqi, veças për objektet dhe veças për pajisjet e aparaturat.
Preventivat do të përfshijnë vetëm shpenzimet për kthimin e objekteve në gjendjen fillestare dhe jo për ndryshime të projekteve bazë.
3. Financimi nga Buxheti i Shtetit i objekteve të dëmtuara bartet në periudhën pasardhëse.
5. Punonjësit e Albtransportit në Tiranë që do të angazhohen me forcat e policisë për ruajtjen e Aeroportit të Rinasit, të shpërblehen deri në trefishin e nivelit ekzistues të pagave.

6. Të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 16.3.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 138, datë 20.3.1997

**PËR ADMINISTRIMIN E DHURIMEVE FINANCIARE NGA PERSONA FIZIKË E
JURIDIKË ME BANIM E SELI BRENDA DHE JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimet financiare nga persona fizikë e juridikë me banim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të depozitohen në dy llogari bankare të posaçme, përkatësisht në lekë dhe në valutë.

2. Përdorimi i dhurimeve të depozituara bëhet nga Ministria e Financave me autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose të Ministrit të Financave, në mungesë ose i autorizuar prej tij. Autorizimi do të lëshohet edhe në rastin e dhurimeve me destinacion, duke u mbështetur në destinacionin e përcaktuar në aktin e dhurimit.

3. Ministria e Financave të bëjë publike, nëpërmjet mjeteve të informacionit publik, numrat e llogarive të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 139, datë 15.3.1997

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjatë periudhës së rivendosjes dhe stabilizimit të gjendjes në njësi e reparte ushtarake, deri në një rishikim tërësor të sistemit të pagave të Ministrisë së Mbrojtjes, punonjësit e sistemit të kësaj ministrie të përfitojnë një shpërblim suplementar që, së bashku me pagën, do të jepet deri në trefishin e nivelit ekzistues të pagës.

2. Ministria e Mbrojtjes miraton masën e shpërblimit suplementar, në bazë të shkallës së angazhimit të strukturave të saj në rivendosjen dhe stabilizimin e gjendjes së reparteve ushtarake.

3. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe të Përkrahjes Sociale, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave strukturën e re dhe sistemin e rishikuar të pagave të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Paga e ushtarëve të shërbimit aktiv të jetë deri në 5000 lekë në muaj.

5. Paga e ushtarit rezervist të jetë deri 1000 lekë në ditë.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 16.3.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 142, datë 21.3.1997

PËR RUAJTJEN FIZIKE TË DISA PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE.

Në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, me qëllim që të sigurohet paprekshmëria e personaliteteve të larta shtetërore, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës (dega e ruajtjes së personaliteteve të marrë në ruajtje, për periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme, gjithë anëtarët e Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, Prokurorin e Përgjithshëm, kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, kryetarin e Gjykatës së Kasacionit, kryetarin e SHIK-ut dhe kryetarin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 143, datë 21.3.1997

**PËR NJË TRANSFERIM TË FONDEVE BUXHETORE SHËRBIMIT INFORMATIV
KOMBËTAR NGA FONDET E AKORDUARA PËR GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME
MINISTRISË SË BRENDSHME**

Për mbajtjen në gatishmëri të efektivave dhe përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme, me propozimin e Shërbimit Informativ Kombëtar, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në planin e shpenzimeve buxhetore të tremujorit të parë të vitit 1997, Shërbimit Informativ Kombëtar i shtohen 25 milionë lekë për pagesën e punonjësve.
2. Shtesa prej 25 milionë lekësh të pakësohet nga plani i shpenzimeve të Ministrisë së Brendshme, akorduar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.121, datë 7.3.1997 "Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Brendshme për përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme".
3. I rekomandohet Shërbimit të Kontrollit të Shtetit të ushtrojë kontroll mbi shpenzimet e kryera nga Shërbimi Informativ Kombëtar për gjendjen e jashtëzakonshme dhe të paraqesë për këtë raportin e plotë në Këshillin e Ministrave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 145, datë 26.3.1997

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMEVE FINANCIARE TË PROGRAMEVE TË
BASHKIMIT EUROPIAN PHARE/CROSS BORDER 1996 PËRKATËSISHT ME ITALINË
DHE GREQINË**

Me propozimin e Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim memorandumet financiare për programet e Bashkimit European PHARE/CROSS BORDER 1996 përkatësisht me Italinë dhe Greqinë, me një vlerë prej 20 milionë ECU.

2. Ngarkohet drejtori i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, ose çdo person tjetër i autorizuar prej tij, të nënshkruajë memorandumet financiare në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Ngarkohet PMU e programit CROSS BORDER pranë Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të menaxhojë të dy programet brenda afteve kohore të përcaktuara në këto memorandume.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 146, datë 26.3.1997

PËR NJË SHITESË FONDESH BUXHETORE PËR PASTRIMIN E QYTETIT TË TIRANËS

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në buxhetin e shpenzimeve korrente për periudhën janar-mars 1997, i shtohen 11.7 milionë lekë për pastrimin e qytetit të Tiranës, që përballohen:

a) 5 milionë lekë nga fondi i kontingjencës i Këshillit të Ministrave i tremujorit të parë të vitit 1997;

b) nga programi i investimeve të tremujorit të parë të vitit 1997 të Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të zbritet nga plani fondi për objektin “Kanalizimi i ujërave të zeza Daullas” në rrethin e Fierit për 6.7 milionë lekë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 147, datë 26.3.1997

PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE SHTETËRORE NGA DREJTORITË E UJËRAVE TË RRETHEVE PËR TREMUJORIN E PARË 1997 PËR REHABILITIMIN E DISA OBJEKTEVE TË UJITJES DHE KULLIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, neni 3, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për tremujorin e parë të vitit 1997 kryerja e punimeve me fonde shtetërore për rehabilitimin e disa objekteve të ujitjes dhe kullimit, me vlerë deri në 3 milionë lekë, bëhet nga drejtoritë e ujërave të rretheve.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të caktojë listën e objekteve përkatëse, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 148, datë 26.3.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.160, DATË 9.7.1975 “PËR NORMAT E USHQIMIT TË USHTRISË DHE TË ORGANEVE E REPORTEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME”

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së efektivave të njësive të emergjencës që do të angazhohen në ruajtjen dhe trajtimin e ndihmave, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nenin 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.160, datë 9.7.1975, pasqyra nr.1, pika 8, të shtohet paragrafi:

“Me normën e ushqimit nr.8 të furnizohen:

- a) efektiv i brigadës së tankeve në Zall-Herr;
- b) efektiv i batalionit të sigurimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ai i ruajtjes e i mbrojtjes së aerodromit të Rinasit;
- c) efektiv i brigadës së transportit;
- ç) efektiv i Policisë Ushtarake që do të angazhohet në ruajtjen e ndihmave;
- d) kuadrot ushtarakë të brigadës “Komando”, si dhe të gjithë kuadrot e reparteve të tjera që do të marrin pjesë dhe do të angazhohen në këtë veprimtari”.

2. Efektet ekonomike nga ndryshimet e mësipërme të përballohen brenda fondeve buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 149, datë 26.3.1997

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET
SOSKINDERDORF INTERNATIONAL DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË
SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratohet në parim marrëveshja kuadër ndërmjet SOSKINDERDORF INTERNATIONAL dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për vazhdimin e bashkëpunimit, duke mbuluar zbatimin e projekteve ekzistuese dhe të projekteve të tjera në të ardhmen, me vërejtjen që të hiqet pikat 1.7 e tekstit të marrëveshjes.
2. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, para nënshkrimit të marrëveshjes, të bëjnë saktësimin përfundimtar të tekstit.
3. Ngarkohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale të nënshkruajë këtë marrëveshje.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 150, datë 21.3.1997

**PËR KALIMIN NË LIKUIDIM TË NDËRMARRJES SË FLOTËS DETARE TREGTARE NË
DURRËS**

Me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të shpallë falimentimin dhe të autorizojë fillimin e procedurave të likuidimit të ndërmarrjes së Flotës Detare Tregtare në Durrës.
2. Procedurat e likuidimit kryhen në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.620, datë 16.9.1996, nga Ministria e Privatizimeve.
3. Porti detar në Durrës do të japë në përdorim të likuidatorëve të Flotës Detare Tregtare një zyrë dhe do të mbulojë pagat e tyre gjatë periudhës së likuidimit.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.86, datë 12.2.1996, shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Privatizimeve dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 153, datë 26.3.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.360, DATË
10.7.1995 “PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NË REPUBLIKËN E**

SHQIPËRISË

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995 “Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.415, datë 7.8.1995; nr.121, datë 12.2.1996 dhe nr.711, datë 21.10.1996, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “Mbeturina dhe skrape të bakrit (me përjashtim të skorjeve prej bakri)”, si dhe fjalët “Artikuj të tjerë prej bakri të derdhur” të ndryshohen dhe të zëvendësohen me fjalët:

“74.01 deri në 74.19 Bakri dhe artikujt prej bakri”.

2. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ndalohet grumbullimi dhe tregtimi i bakrit dhe i artikujve prej bakri sipas klasifikimit të mallrave nga 74.01 deri në 74.19”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM Nr. 154, datë 30.3.1997

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË PASAPORTAVE TË ZAKONSHME TIP I VJETËR SI DOKUMENT IDENTITETI DHE PAJISJEN ME PASAPORTA TË REJA

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Afati i vlefshmërisë së pasaportave të zakonshme tip i vjetër, që do të shërbejnë vetëm si dokument identiteti dhe jo si dokument udhëtimi jashtë shtetit, për shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë shteti, shtyhet gjer më 31 dhjetor 1997.

2. Për të gjitha rastet e kërkesave të paraqitura rregullisht në përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë nga shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit deri më 31 maj 1997 procesi i pajisjes së tyre me pasaporta të zakonshme të reja duhet të përfundojë deri në datën 31 dhjetor 1997.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Ministria e Brendshme duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përshpejtuar procesin e plotësimit të pasaportave të reja, mbi bazën e kërkesave të paraqitura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM Nr. 159, datë 6.4.1997

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR STATUSIN E FORCAVE SHUMËKOMBËSHE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA (VENDEVE DËRGUESE)

Duke u bazuar në rezolutën 1101 (1997) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 “Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim projekt marrëveshjen model për statusin e forcave shumëkombëshe, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara (vendeve dërguese), me vërejtjen që varianti i parë dhe i mundshëm për juridiksionin të jetë varianti miks.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme që, mbi bazën e kësaj projekt marrëveshjeje, të zhvillojë bisedime me shtetet pjesëmarrëse në këto forca shumëkombëshe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 165, datë 11.4.1997

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM QEVERTAR PËR KOORDINIMIN E
VEPRIMTARISË SHETËTËRORE NË MARRËDHËNIET ME PËRFAQËSUESIT E
MISIONEVE/FORCAVE SHUMËKOMBËSHE TË PRANISHME NË SHQIPËRI**

Duke u bazuar në rezolutën 1101 (1997) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në vendimin nr.160, datë 27.3.1997 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 “Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e komisionit të posaçëm qeveritar për koordinimin e veprimtarisë shtetërore në marrëdhëniet me përfaqësuesit e misioneve/forcave shumëkombëshe të pranishme në Shqipëri.

2. Komisioni ka si detyrë kryesore të koordinojë veprimtarinë e institucioneve shtetërore për të përgatitur gjithë kuadrin e nevojshëm ligjor e teknik për ardhjen dhe veprimin e papenguar të misioneve/forcave shumëkombëshe, mbajtjen e komunikimit të rregullt me to, si dhe trajtimin e problemeve të ndryshme që hasen në veprimtarinë e tyre, duke u sugjeruar zgjidhjet e duhura institucioneve përkatëse.

3. Kryetar i këtij komisioni caktohet Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

4. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, veprimtaria e të cilave është e lidhur drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e misioneve/forcave shumëkombëshe të pranishme në Shqipëri, sipas listës së bashkëngjitur këtij vendimi. Lista emërore miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozimin e kryetarit të komisionit.

5. Institucionet që kanë përfaqësues të tyre anëtarë të komisionit, të krijojnë të gjitha kushtet lehtësuese për veprimtarinë e komisionit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

LISTA EMËRORE E KOMISIONIT TË POSAÇËM QEVERTAR PËR KOORDINIMIN E
VEPRIMTARISË SHETETËRORE NË MARRËDHËNIET ME PËRFAQËSUESIT E
MISIONEVE/FORCAVE SHUMËKOMBËSHE TË PRANISHME NË SHQIPËRI

1. Z. Pavli Zëri	Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Jashtme
2. Z. Ali Kazazi	Zv. Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Mbrojtjes
3. Z. Lush Përbali	Zv. Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Brendshme
4. Z. Fatmir Hakani	Anëtar	Këshilltar i Kryeministrit
5. Z. Ferit Hoxha	Anëtar	Drejtor Politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme
6. Z. Albert Beja	Anëtar	Drejtor Politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme
7. Z. Kristo Micaco	Anëtar	Drejtor në Ministrinë e Financave
8. Z. Alket Kashahu	Anëtar	Përfaqësues i pushteti lokal
9. Z. Sali Metani	Anëtar	Drejtor në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit

VENDIM
Nr. 167, datë 11.4.1997

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT ITALIAN NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (IDA), SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT TË DHËNA NGA REPUBLIKA E ITALISË PËR PROJEKTIN E
PYJEVE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e grantit italian prej 8.5 milionë dollarësh ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), si administratore e fondeve grant të dhëna nga Republika Italiane për projektin e pyjeve.

2. Autorizohet Ministri i Financave, ose ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, të nënshkruajë marrëveshjen e grantit italian të lartpërmendur, si dhe dokumentet e tjera të lidhura me të.

3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, nëpërmjet njësisë së zbatimit të projektit, për përdorimin e fondeve në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 169, datë 11.4.1997

**PËR PROKURIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR PËR DISA ARTIKUJ QË
LIDHEN ME PLOTËSIMIN E NEVOJAVE URGJENTE PËR FUNKSIONIMIN E
BURGJEVE DHE INSTITUCIONEVE TË RIEDUKIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vetëm për plotësimin e nevojave që lidhen me funksionimin e burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit, për artikuj ushqimorë, veshmbathje, kazermim dhe ndërlidhje, të përdoret

“Kërkesa për kuotim” me kushtet vijuese:

a) Koha e përgatitjes së ofertës të jetë jo më pak se 1-3 ditë.
b) Shoqërisë fituese t’i kërkohej si dokumentacion ligjor vetëm licenca e ushtrimit të veprimtarisë. Kjo të pranohet edhe e panoterizuar, me kusht që komisionit t’i paraqitet origjinali për verifikimin e besueshmërisë së fotokopjes.

c) Pagesa e mallrave, shërbimeve të bëhet me lekë në dorë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve autorizohet të përcaktojë të gjitha nevojat që lidhen me funksionimin e burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i zbatueshëm për periudhën 1.4.1997 gjer më 30.6.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 170, datë 8.4.1997

PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë” dhe me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare Kinematografike, e krijuar sipas ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, do të jetë institucion buxhetor me klasifikim më vete në strukturën buxhetore si grup, titull, kapitull.

2. Numri i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të jetë 10 veta.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve në institucionet buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

- Në lidhjen nr.I “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe personave të një rangu me ta”, në pikën 8 dhe në lidhjen nr.II-5 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pikën 3 shtohet emërtimi “Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.

- Në lidhjen nr.I “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe personave të një rangu me ta”, në pikën 11 dhe në lidhjen nr.II-5 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pikën 6 shtohet emërtimi “Drejt看 ekzekutiv”.

- Shtohet lidhja II-15 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave të përballohen nga buxheti i miratuar për sektorin e kinematografisë për vitin 1997.

5. Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

LIDHJA II-15

PAGAT MUJORE DHE RENDITJA E DETYRAVE SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Nr.	Emërtimi	Paga ose klasa	Shtesa për funksion (grupi)
-----	----------	----------------	-----------------------------

1.	Kryetar	37 000	
2.	Drejtor ekzekutiv	28 800	
3.	Shef sektori	IX	5
4.	Specialist i parë	VIII	
5.	Specialist i dytë	VII	
6.	Llogaritar i parë	V	
7.	Shofer	IV	

Shënim. Nëse del e nevojshme të ketë emërtesa të tjera, të përdoret lidhja III-5/37 “Renditja e detyrave sipas klasave për profesione të njëjta në të gjithë sektorët” dhe pagat të caktohen sipas lidhjes II/M.

VENDIM
Nr. 171, datë 19.4.1997

PËR FUNKSIONET E SEKRETARËVE TË SHTETIT NË QEVERINË E PAJTIMIT KOMBËTAR

Mbështetur në konsensusin e partive politike nënshkruese të marrëveshjes së 9 marsit 1997, si edhe për të mundësuar realizimin e funksioneve të sekretarëve të shtetit në ministrinë ku ata janë emëruar, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sekretarët e shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes ushtrojnë funksione koordinuese dhe drejtuese të politikës në ministrinë përkatëse.

Sekretari i shtetit drejton veprimtarinë e përditshme të sektorëve të veçantë të ministrisë, të caktuar nga ministri përkatës në bashkëpunim me sekretarin e shtetit.

2. Sekretarët e shtetit nënshkruajnë, së bashku me ministrat përkatës, projektet e akteve dhe relacionet e tyre që ia paraqiten për shqyrtim Këshillit të Ministrave, si dhe aktet me karakter individual a normativ që nxirren nga ministrinë ku ata janë emëruar.

Projektet e akteve të mësipërme i dërgohen paraprakisht për nënshkrim sekretarit të shtetit, i cili, përpara nënshkrimit, ka të drejtë të kërkojë sqarime plotësuese nga punonjësit e ministrisë që janë marrë me përgatitjen e tyre.

Pas nënshkrimit të sekretarit të shtetit, këto projekte i kalojnë për nënshkrim ministrit përkatës.

3. Të gjitha aktet individuale dhe normative që nxirren nga sekretarët e shtetit për sektorët që ata drejtojnë, nënshkruhen edhe nga ministrat përkatës.

4. Problemet që lindin lidhur me vërejtjet ose sugjerimet për ndryshimin dhe përmirësimin e projekteve të akteve ndërmjet ministrave dhe sekretarëve të shtetit, zgjidhen me konsensus ndërmjet tyre. Nëse ky konsensus nuk arrihet, atëherë mosmarrëveshja shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave.

5. Sekretarët e shtetit kanë të drejtë të thërrasin për ndihmë, konsulencë ose informacion, nëpunës a organe të ministrive përkatëse që nuk i përkasin sektorit që ata drejtojnë. Në këtë rast sekretari i shtetit nuk ushtron ndaj këtyre nëpunësve a organeve pushtet hierarkik ose organizativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij deri në mbarimin e veprimtarisë së Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 172, datë 19.4.1997

PËR SHPALLJEN E SHQIPËRISË VEND I LIRË NGA AFTA EPIZOOTIKE

Mbështetur në ligjin nr. 7674, datë 23.2.1993 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, rekomandimet e BE-së për aftën epizootike në Republikën e Shqipërisë dhe gjendjen epizootike tashmë nën kontroll të plotë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Republika e Shqipërisë të shpallet vend i lirë nga sëmundja e aftës epizootike.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Punëve të Jashtme të njoftojnë për sa më sipër organizmat ndërkombëtarë, BE-në dhe shtetet, me të cilat kemi marrëveshje veterinare, dhe njëkohësisht të kërkojnë prej tyre heqjen e bllokimit për eksportet shqiptare të kafshëve dhe prodhimeve me origjinë nga kafshët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 178, datë 19.4.1997

PËR SHPENZIMET E KTHIMIT NË ATDHE TË TRUPIT TË MJEKUT ZAMIR SHAZI

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet për kthimin në atdhe të trupit të mjekut kirurg Zamir Shazi përballohen nga Buxheti i Shtetit i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Ambientit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit, si dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 179, datë 19.4.1997

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.235, DATË 16.4.1996 “PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 16.4.1996, në pikën 3/b, pas fjalëve “Zëvendësministër dhe Drejtor i Përgjithshëm i Policisë” shtohen fjalët “Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve”.
2. Në fund të kësaj pike shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Zv.drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve” 29 000 lekë.
3. Efektet financiare të këtyre ndryshimeve të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 1 janar 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 180, datë 11.4.1997

**PËR PROKURIM ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR PËR DISA ARTIKUJ QË
LIDHEN ME PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË GATISHMËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për plotësimin e nevojave që lidhen me gatishmërinë për artikujt ushqimorë, veshmbathjes, kazermimit, automekanikës dhe ndërlidhjes, Ministria e Brendshme dhe organet e repartet në varësi të saj të përdorin “Kërkesën për kuotim” në kushtet e mëposhtme:

- Kufiri për çdo blerje deri në 5 milionë lekë.
- Shoqërisë fituese t’i kërkohet si dokumentacion ligjor licenca e ushtrimit të veprimtarisë dhe dokumenti i regjistrimit në organet tatimore.

2. Ministri i Brendshëm autorizohet të përcaktojë të gjitha nevojat që lidhen me gatishmërinë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i zbatueshëm për periudhën 12.4.1997-15.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 181, datë 19.4.1997

**PËR PROKURIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR PËR RIKONSTRUKSIONIN E
MEREMETIMIN E OBJEKTEVE TË KOMISARIATEVE DHE REPARTEVE TË
MINISTRISË SË BRENDSHME**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për rikonstruksionin dhe meremetimet e objekteve autorizohen komisaritet e repartet e Ministrisë së Brendshme të përdorin “Kërkesën për kuotim”, me përjashtimet vijuese:

- a) Vlera e përlogaritur e kontratës të jetë deri në 10 milionë lekë.
- b) Afati i dorëzimit të ofertës të jetë jo më pak se 5 ditë.
- c) Shoqërisë kontraktuese t’i kërkohet si dokumentacion ligjor vetëm licenca e ushtrimit të veprimtarisë dhe dokumenti i regjistrimit në organet tatimore.

2. Ministri i Brendshëm përcakton fondin e investimit të nevojshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme të komisariateve dhe reparteve.

3. Prokurimi të realizohet brenda fondeve buxhetore të dhëna për këto investime.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i zbatueshëm dari në datën 30.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 182, datë 19.4.1997

PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që të prokurojë drejtpërdrejt për artikujt e mëposhtëm, përkatësisht me firmat:

1. Me firmën SRNS Durrës	
- Ripetitor 20-25 W, 420-470 Mhz, copë 5 në fondin limit	1 500 000 lekë
- Antena fibër xhami, copë 5 në fondin limit	150 000 lekë
- Radio portative 5 W, 420-470 Mhz, copë 50 në fondin limit	3 750 000 lekë
- Bateri ENB-10, copë 60 në fondin limit	200 000 lekë
- Aparate telefonike automatike, copë 200 në fondin limit	400 000 lekë
2. Me firmën CO, RA, TEL.Tiranë	
- Aparate celularë ericsson, copë 3 në fondin limit	400 000 lekë
- Bateri Maxon SA 1155, copë 30 në fondin limit	210 000 lekë
3. Me firmën I.B.C.Tiranë	
- Central telefonik automatik 40-50 N, copë 4 në fondin limit	3 000 000 lekë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 183, datë 19.4.1997

PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që shërbimet e riparimeve dhe të mirëmbajtjes së teknikës që disponojnë organet e repartet e saj, t'i prokurojë drejtpërdrejt me shoqërinë tregtare "Oficina auto e rendit publik".

2. Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që për vënien në gatishmëri të teknikës speciale që disponon në sektorin auto, të prokurojë drejtpërdrejt me firmat prodhuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet gjer më 30.6.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 184, datë 19.4.1997

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 6.4.1997 “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR STATUSIN E FORCAVE SHUMËKOMBËSHE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA (VENDEVE DËRGUESE)”

Duke u bazuar në rezolutën 1101 (1997) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 “Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare”, duke pasur parasysh qëndrimin e shteteve pjesëmarrëse në forcat shumëkombëshe në procesin e bisedimeve, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.159, datë 6.4.1997, pika 1 ndryshohet si vijon:
“Të miratojë në parim projekt marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverive të shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe, lidhur me statusin e këtyre forcave, me vërejtjen që për juridiksionin të jetë varianti B në tekstin e bashkëngjitur”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme që, mbi bazën e kësaj projekt marrëveshjeje, të zhvillojë bisedime me shtetet pjesëmarrëse në këto forca shumëkombëshe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 186, datë 25.4.1997

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË FINANCIMIT PËR PËRFUNDIMIN E PERDES SË KUNDËRFILTRIMIT NË IMPIANTIN HIDROTEKNIK TË BOVILLËS

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e financimit prej 60 milionë lekësh (450 mijë USD) për kontratën fillestare, për vazhdimin e punimeve në perden e kundërfiltrimit në impiantin hidroteknik të Bovillës.

Fondi prej 60 milionë lekësh të përballohet nga programi i investimeve për vitin 1997 i Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 187, datë 25.4.1997

PËR ZBATIMIN E PËRKOHSHËM, QË NGA MOMENTI I NËNSHKRIMIT, TË “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE

**QEVERIVE TË SHTETEVE KONTRIBUESE NË FORCËN MBROJTËSE
SHUMËKOMBËSHE PËR STATUSIN E KËSAJ FORCE”**

Në mbështetje të nenit XIV, pika 2 të marrëveshjes së lartpërmendur, duke u nisur nga nevoja urgjente e zbatimit të menjëhershëm të kësaj marrëveshjeje, për shkak të pranisë aktuale në Shqipëri të forcave mbrojtëse shumëkombëshe, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të fillojë zbatimin e përkohshëm, që nga momenti i nënshkrimit, të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverive të shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe për statusin e kësaj force”, nënshkruar në Romë, më 21.4.1997, deri në ratifikimin e saj nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme që, në bazë të dispozitave të marrëveshjes, të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e përmbajtjes së saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

**VENDIM
Nr. 196, datë 2.5.1997**

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT “ZOOTEKNIA E INTEGRUAR NË SHQIPËRI” DHE FINANCIMIN E TIJ ME GRANT TË QEVERISË ITALIANE

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit dhe të Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit “Zooteknia e integruar në Shqipëri” dhe financimin e tij me grant nga Qeveria italiane.

2. Financimi për këtë projekt për shumën deri 6 900 000 000 lireta do të mbulohet nga Qeveria italiane.

3. Miratohet protokolli ekzekutiv i nënshkruar në emër të Qeverisë shqiptare nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe në emër të Qeverisë italiane nga ambasadori i Italisë në Tiranë.

4. Pagesat për TVSH-në për importet që furnizohen nga projekti, do të përballohen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit nga fondi i koston lokale të projektit.

5. Për zbatimin e këtij projekti ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

**VENDIM
Nr. 197, datë 2.5.1997**

**PËR AUTORIZIMIN E HYRJES MBI BAZË TË PËRKOHSHME PËR ARSYE
HUMANITARE NË UJËRAT TONA TERRITORIALE TË ANIJEVE TË SPECIALIZUARA
ITALIANE**

Duke pasur parasysh situatën tepër të vështirë që kalon vendi, për shkak të cenimit të rëndë të

rendit ligjor, me pasoja edhe në vendet e tjera; duke u nisur nga qëllimi për të parandaluar e shmangur në masën më të madhe të mundshme rrezikimin e jetës së njerëzve që tentojnë të largohen nga vendi në mënyrë të paligjshme; duke u bazuar në dekretin nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror”, neni 7; duke iu referuar kërkesës dhe gatishmërisë së Qeverisë italiane, me propozimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë hyrjen në zona të përcaktuara të ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë për një periudhë 3-mujore të anijeve të specializuara italiane, periudhë që mund të shtyhet përsëri me vendim.

2. Përveç rasteve të përcaktuara në dekret, hyrja e këtyre anijeve mund të bëhet vetëm për të shoqëruar kthimin në portin e nisjes të anijeve me flamur shqiptar e të huaj, që transportojnë shtetas shqiptarë që kanë kryer vepra penale dhe tentojnë të largohen në mënyrë të paligjshme nga Shqipëria për në Itali, si dhe në rastet kur rrezikohet jeta e tyre.

3. Hyrja e këtyre anijeve mund të bëhet vetëm pas një njoftimi paraprak të autoriteteve portuale shqiptare, duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi.

4. Hyrja e anijeve dhe veprimtaria e tyre do të bëhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara në protokollin ndërmjet ministrive të mbrojtjes të të dy vendeve (teksti i bashkëlidhur), të nënshkruar në Romë, më 2 prill 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr. 198, datë 2.5.1997

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.621, DATË 20.12.1993 “PËR KOMPETENCAT NË DHËNIEN E LEJEVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E TRANSPORTIT”, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.763, DATË 11.11.1996

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, ndryshuar me vendimin nr.763, datë 11.11.1996, bëhen këto ndryshime:

- Titulli ndryshohet si vijon:

“Për kompetencat në dhënie e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit dhe të industrisë”.

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë përcakton rregullat përkatëse për kriteret, kushtet dhe procedurat për lëshimin e lejeve të ushtrimit të veprimtarive në fushat e transportit e të industrisë, si dhe për masat që merren për shkeljen e tyre”.

- Pika 2 ndryshohet si vijon;

“Lejet për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit dhe të industrisë lëshohen nga organet sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi”.

- Në pikat 3 dhe 4 fjalët “Ministria e Transporteve” të zëvendësohen me fjalët “Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë”.

2. Lista që i bashkëngjitet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 11.11.1996, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E TRANSPORTIT DHE TË INDUSTRISË, PËR TË CILAT
KËRKOHEJ LEJE E LËSHUAR NGA:

A. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë

I. Në transportin rrugor:

1. Në transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetëse dhe ndërkombëtare.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave.
3. Për veprimtarinë e shërbimit të agjencive të udhëtarëve, të mallrave dhe spedicionerëve.
4. Për përgatitjen dhe kualifikimin e drejtuesve të automjeteve.
5. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik, së bashku me servis-riparimin.

Miratimi paraprak për veprimtarinë e servis-riparimit të subjekteve të huaja ose në bashkëpunim.

II. Në transportin detar, ujqor dhe portet:

1. Për veprimtarinë për transportin detar të mallrave dhe/ose udhëtarëve midis porteve dhe pontileve detare brenda dhe atyre në transportin ujqor (liqenet etj.).
2. Për transportin detar e ujqor ndërkombëtar për mallra dhe/ose për udhëtarë.
3. Për shërbimet e agjencive detare, të pilotimit, spedicionit dhe ngarkim-shkarkimit në porte.

III. Në ushtrimin e veprimtarisë në fushën e industrisë:

1. Për industrinë mekanike (fonderi, përpunim pjesë këmbimi).
 2. Për industrinë e përpunimit të lëkurë-këpucës, të gomës dhe të plastikës.
 3. Për industrinë e konfeksioneve prej tekstilësh të pambukta, të leshta dhe përzierjeve të tyre.
 4. Për industrinë përpunuese të drurit (lëndë të para, mobilie, detale).
 5. Për industrinë e prodhimeve kimike të konsumit.
 6. Për industrinë e prodhimit të qelqit dhe të qeramikës (fajancë, porcelan).
- IV. Për ushtrimin e veprimtarive të lira në fushat e transportit dhe të industrisë:
1. Për ushtrimin e veprimtarisë së konsulencës teknike, projekteve dhe shërbimeve teknike në fushat e transportit dhe të industrisë.

B. Nga këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve

I. Në fushën e transportit rrugor:

1. Në transportin qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve me autobus dhe transportin taksi, sipas përcaktimeve të urdhërësës së Këshillit të Ministrave nr.7, datë 17.8.1993.
2. Për veprimtarinë e transportit të mallrave brenda vendit.
3. Për veprimtarinë e servis-riparimit të mjeteve të transportit rrugor, shërbimin dhe rimorkimin e mjeteve të difektuara në rrugë, larjen e automjeteve, parking, gomisteri etj.

II. Në fushën e transportit detar e ujqor:

1. Për veprimtarinë në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve në liqene brenda rrethit.
2. Për veprimtarinë në linjë me spontimin e mallrave nga anijet dhe kryerjen e mjeteve të transportit detar dhe ujqor.

III. Në fushën e transportit hekurudhor:

1. Në veprimtarinë e shërbimeve të ndryshme për mallrat në stacione.

VENDIM
Nr. 199, datë 2.5.1997

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7845, DATË 13.7.1994 "PËR NUMRIN E SIGURIMIT
SHOQËROR"**

Në mbështetje të nenit 13 dhe për zbatim të neneve 6, 7 e 12 të ligjit nr.7845, datë 13.7.1994

“Për numrin e sigurimit shoqëror”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (më poshtë “ISSH”) vendos numrin e sigurimit shoqëror, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal.

2. Numri i sigurimit shoqëror është një numër me dhjetë elemente, me informacion të koduar dhe me këtë strukturë:

Elementi 1-2	viti i lindjes
Elementi 3-4	muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	data e lindjes
Elementi 7-9	numri i vazhdueshëm brenda së njëjtës datë
Elementi 10	element kontrolli.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore përcakton mënyrën dhe veprimet që kryhen për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror.

ISSH pajis me numër të sigurimit shoqëror gjithë personat e siguruar brenda muajit mars 1998.

3. Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal:

a) ngarkon drejtuesit e zyrave të gjendjes civile të bashkëpunojnë me përfaqësuesit e ISSH-së për të marrë informacionin e duhur për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror;

b) krijojnë mundësinë e përfaqësuesve të ISSH-së të shfrytëzojnë regjistrin e gjendjes civile;

c) cakton personat që do të plotësojnë formularët e regjistrimit të numrit të sigurimit shoqëror (më poshtë “Formulari”), të cilët do të jenë punonjës të zyrave të gjendjes civile;

ç) organizon punë në zyrat e gjendjes civile për plotësimin e formularëve me të dhënat e nevojshme personale për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror;

d) emëron një përfaqësues në grupin e punës të ISSH-së;

dh) për punën e kryer punonjësit e zyrave të gjendjes civile do të shpërblehen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore:

a) përcakton dhe miraton modelin e formularit, organizon prokurimin, shtypjen dhe shpërndarjen e tyre;

b) përcakton, prokuron dhe vë në punë sistemin teknik të nevojshëm;

c) cakton inspektorët e ISSH-së që do të kontrollojnë dhe mbikëqyrin punën e kryer nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe do të jenë përgjegjës për rezultatet e punës së tyre dhe do të mbledhin formularët;

ç) paguan punonjësit e zgjedhur për plotësimin e formularëve me 5 lekë për çdo formular të plotësuar, vetëm kur inspektorët e ISSH-së kanë pranuar dhe miratuar rezultatin e punës së kryer;

d) trajnon inspektorët e ISSH-së dhe punonjësit e zyrave të gjendjes civile që do të plotësojnë formularët;

dh) përcakton afatet dhe procedurën e mbledhjes së formularëve;

e) informon personin për numrin e tij të sigurimit shoqëror;

ë) përcakton metodën, mjetet dhe vendin e ruajtjes së formularëve;

f) planifikon, miraton, prokuron, shtyp dhe shpërndan formularët tip të parashikuar në pikën 7 të këtij vendimi.

5. Formulari përmban të dhënat e nevojshme për vendosjen e numrit të sigurimit shoqëror. Plotësimi i formularëve bëhet sipas një mënyre të përcaktuar nga ISSH dhe që lejon leximin e tyre me mjete teknike. Procesi i plotësimit të formularëve do të përfundojë në datën 30 tetor 1997.

6. Ndërmjet përfaqësuesit të ISSH-së dhe punonjësit të zyrës së gjendjes civile lidhet aktmarrëveshje, e cila përcakton detyrimin për plotësimin e formularëve, afatin e plotësimit, cilësinë e punës dhe mënyrën e pagesës.

7. Nga data 1.1.1998 zyrat e gjendjes civile do të informojnë rregullisht regjistrin qendror të ISSH-së për lindjet, vdekjet dhe çdo ndryshim tjetër në aktet e gjendjes civile që ata regjistrojnë. Për

këtë qëllim ISSH-ja do të përcaktojë formularë tip. Inspektorët e ISSH-së kanë të drejtë ta mbikëqyrin këtë veprimtari që do të kryhet nga zyrat e gjendjes civile.

8. Agjencitë bankare ku derdhen kontributet për sigurimet shoqërore, agjencitë paguese të përfitimeve nga sigurimet shoqërore, si dhe punëdhënësit që paguajnë kontribute për punëmarrësit e tyre, detyrohen të përdorin numrin e sigurimit shoqëror për të treguar personin, në favor të të cilit janë derdhur kontributet ose janë paguar përfitimet.

9. Për zbatimin e nenit 12 të ligjit, Këshilli i Ministrave nxjerr vendim të veçantë.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal të nxjerrin udhëzime të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

11. Shpenzimet financiare do të përballohen nga projekti i Bankës Botërore dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.200, datë 2.5.1997

PËR DISA MASA PËR FORCIMIN E RUAJTJES SË MALLRAVE, PAJISJEVE E
OBJEKTEVE USHTARAKE DHE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ndalohet grumbullimi, transporti i artikujve të përcaktuar në kreun 72 deri 81; 84.25 deri në 84.33; 85.01 deri 85.14 dhe kreun 93, sipas emërtesës së mallrave në fuqi, pa pasur autorizimin përkatës nga organi kompetent. Lista e mallrave të mësipërme përcaktohet në aneksin nr.1.

2. Ndalohet grumbullimi, transportimi dhe përpunimi i të gjitha llojeve të mbeturinave, skrapeve, pjesëve të makinerive, radiatorëve, tornove, pjesëve të armëve, municioneve dhe llojeve të tjera, si dhe prodhimi i lingotave dhe kallëpeve të derdhura nga këto materiale.

3. Të sekuestrohen të gjitha linjat dhe fonderitë e ngritura pa lejen e organeve kompetente, të cilat merren me grumbullimin dhe përpunimin e skrapeve të të gjitha llojeve.

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995, pas paragrafit të fundit të pikës 2 shtohen paragrafët e mëposhtëm:

- Çeliquet të pandryshkëm (7218).

- Materiale për ndërtimin e hekurudhës, si shina, pllaka mbështetëse e pjesë të tjera të kësaj natyre (7302).

- Konstruksiione e pjesë konstruktive të urave (7308).

- Rezervuarë dhe depozita (7309).

- Tela të të gjitha llojeve (7312-13).

- Zinxhirë dhe pjesët e tyre (7315).

- Makineri të të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre, si torno, freza etj.

5. Me forcat e policisë së Ministrisë së Brendshme, policisë ushtarake dhe të policisë tatimore doganore të krijohen postblloqe (truprojë), në vendkalimet e mundshme të kufirit shtetëror dhe në rrugët që të çojnë në to. Këto postblloqe shpallen objekte të rëndësisë së veçantë.

6. Organet e policisë së strukturave, të përmendura në pikën 5, të forcojnë masat e kontrollit për ndalimin e eksportimit të mallrave, armatimit, municionit, teknikës luftarake, pjesëve të tyre, si dhe të çdo pajisjeje tjetër ushtarake.

7. Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për bllokimin e rrugëve që të çojnë drejtpërdrejt në territorin e depove ushtarake. Hyrjet e depove, tuneleve dhe territori rreth tyre të minohen.

8. Ruajtja e objekteve ushtarake të kryhet me oficerë, nënoficerë, ushtarë aktivë dhe roja

rezerviste.

9. Ministria e Brendshme të dorëzojë në garnizonet ushtarake të përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes, armatimin, municionin dhe pajisjet ushtarake që kapen, sipas ligjit të gjendjes së jashtëzakonshme.

10. Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për reduktimin dhe përqendrimin e depove të armatimit e municionit, duke parë edhe mundësinë e sigurimit të ndihmës nga forcat shumëkombëshe që veprojnë në Shqipëri.

11. Në rast shkeljeje të pikave 1, 2, 4 të këtij vendimi ndaj personave fajtorë, përveç rasteve të parashikuara në ligj, të sekuestrohen mallrat e kapura dhe mjetet e transportit.

12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

ANEKSI NR.1

Lista e mallrave kryesore që ndalohen të grumbullohen dhe të transportohen pa autorizimin e organit kompetent

1. Hekur dhe çelik i palidhur me lingota ose forma të tjera (7226)
- 1/1 Çelique të pandryshkshëm (7218)
2. Bakër dhe çdo artikull prej tij (74)
3. Nikel dhe artikuj prej tij (75)
4. Alumin dhe artikuj prej tij (76)
5. Plumbi (78)
6. Zinku (79)
7. Kallaj (80)
8. Materiale të tjera si tungsten, molibden, kobalt, titaniu (81)
9. Makara, vinça, kriket ngritës dhe pjesët e tyre (8425)
10. Vinça, vagonë etj. dhe pjesët e tyre (8426)
11. Vagonë ngritës me pirun, vagonë të tjerë dhe pjesët e tyre (8427)
12. Makineri të tjera ngritëse, ngarkim-shkarkimi, teleferikë, ekskavatorë dhe pjesët etj (8430)
13. Buldozerë dhe pjesët e tyre (8429)
14. Armë, municion dhe pjesët e tyre (93)
15. Materiale të ndërtimit hekurudhor, si shina, pllaka mbështetëse e pjesët e kësaj natyre

(7302)

16. Konstruksiione e pjesë konstruktive të urave (7308)
17. Rezervuarë dhe depozita (7309)
18. Tela të të gjitha llojeve
19. Zixhirë dhe pjesë të tyre
20. Motorë të të gjitha llojeve
21. Makineri të të gjitha llojev e dhe pjesët e tyre, si torno, radiatorë dhe freza etj.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGJA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 4.3.2004

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë